



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË

MBI PROGRAMET E STUDIMIT MASTER NË GREQI

VITI AKADEMIK 2019-2020

Universiteti i Peloponezit në Greqi, në bashkëpunim me Departamentin e Shkencave Politike dhe Sociale, Departamentin e Trashëgimisë Kulturore të Universitetit të Bolonjës (Itali), Institutin Kombëtar të Gjuhëve dhe Qytetërimeve Orientale të Universitetit të Sorbonës (Francë), Departamentin e Marrëdhënieve Ndërkombëtare të Universitetit Jashar (Turqi), Departamentin e Ekonomisë dhe Financave të Universitetit Neapolis të Pafos (Qipro) dhe Akademisë Verore Olimpia, ofron studime Master në “*Mediterranean Studies*” për 26 studentë të huaj, për vitin akademik 2019-2020.

Studimet Mesdhetare në MA përfshijnë një sërë programesh studimi si: shkenca politike, marrëdhënie ndërkombëtare, ekonomiks dhe studime kulturore etj. Programi i studimeve zhvillohet në gjuhën angleze, me kohë të plotë dhe zgjat dymbëdhjetë muaj.

Kandidatët duhet të kenë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze, si dhe njohja e një gjuhe Mesdhetare do të ketë prioritet. Gjithashtu, kandidatët duhet të kenë diplomë në programe studimi si: Shkenca Politike, Marrëdhënie Ndërkombëtare, Sociologji, Studime Kulturore, Ekonomiks dhe Juridik. Kandidatët, të cilët janë të pajisur me diplomë nga një institucion i huaj duhet të bëjnë njohjen e nivelit akademik, pas pranimit nga universiteti përkatës në një program të caktuar studimi.

Për një informacion më të detajuar për tarifën e shkollimit, mënyrën e aplikimit dhe të përgatitjes së dokumentacionit, ju lutemi referojuni materialit bashkëlidhur si dhe informacionit në adresën web-site:

http://pedis.uop.gr/?page_id=1949; <https://pedis.uop.gr/pydio/data/public/51ebf8.php>; e-mail: pms-med@uop.gr.

Afati i fundit për aplikim është data **12 Korrik 2019**.

Të gjitha dokumentet duhet të dërgohen me *postë* në adresën e mëposhtme:

“M.A in Mediterranean Studies”

Postgraduate Admissions

Department of Political Science & International Relations

University of the Peloponnese

1 Aristotelous St. & Athino Ave

GR-20132 Corinth

GREECE

DREJTORIA E INTEGRIMIT, KOORDINIMIT, MARRËVESHJEVE DHE ASISTENCËS